



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401746/6

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë dërgimin e kopjeve të dokumentacionit të plotë të dosjes së pensionit të pleqërisë të shtetasit Q.F.*

Drejtuar : **Z. Adem LALA**
Drejtore i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve
Shoqërore

KUKËS

Zoti Drejtor,

Siç jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nisur nga shkrimi i publikuar në median elektronike Shqiptarja.com, më datë 07.10.2014, me titull: "*Kukës, invalidët prej 5 muajsh pa pension, shkak verifikimi i dosjeve*", filloi me iniciativën e tij këtë çështje.

Nëpërmjet këtij shkrimi jemi vënë në dijeni se një pjesë e invalidëve të punës në Qarkun e Kukësit nuk përfitojnë pensionet e invaliditetit, duke shtuar problemet ekonomike të familjeve të tyre. Kjo situatë ka krijuar vështirësi ekonomike dhe jetese për ta. Sipas shoqatës së invalidëve të punës të këtij qarku, rreth 309 dosje janë dërguar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për verifikime.

Një prej invalidëve, është edhe shtetasi Q.F, invalid pune, të cilit i është ndërprerë pensioni i invaliditetit që prej 5 muajsh. Megjithëse është interesuar si pranë DRSSH-Kukës, por edhe ISSH-së, nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Për shqyrtimin e kësaj çështje iu drejtuam institucionit tuaj për të na dhënë shpjegime për ndërprerjen e pensionit të invaliditetit të shtetasit Q.F. Gjithashtu të na sqaronin nëse ishin dërguar dosjet e pensionit të invaliditetit të Qarkut Kukës pranë ISSH-së. Nëse po, cilat ishin arsyet e verifikimit të dosjeve përkatëse si dhe bazueshmërinë ligjore të ndërprerjes së pensionit të invaliditetit të shtetasit Q. F dhe të invalidëve të tjerë të punës.

Me shkresën nr.3275/1 datë 30.10.2014, na informoni se nga Auditimi i 309 dosjeve të pensioneve të invaliditetit të pjesshëm, ka rezultuar se disa nga këto përfitime nuk kanë qenë të rregullta dhe janë lidhur në kundërshtim me Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me shtetasin Q.F, i është kërkuar që të paraqiste pranë DRSSH-së Kukës librezën e punës, pasi nuk ndodhej në dosje, me qëllim verifikimin e saj dhe më pas dosja të ridërgohej në KMCAP-in Epror për t’u vlerësuar për aftësinë në punë. Pas rikontrollit të dosjes pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dosja është kthyer përsëri pranë DRSSH-së Kukës sipas Akt-konstatimit datë 08.10.2014.

Sipas këtij akti, rezulton se nga rikontrolli i dosjes së shtetasit Q.F, me vendimin nr.12 datë 24.01.1998 të KMCAP-it Kukës, përfituesit i është caktuar pension invaliditeti i pjesshëm me datë fillimi të invaliditetit, vitit 1984 (pa datë dhe muaj), si dhe datë e fillimit të përfitimit 10.08.1998. Kjo llogaritje është e gabuar dhe jo ligjore...

“...Invalidi ka punuar me kohë të plotë si punëtor n/toke nga 25.06.1984 deri më datë 01.09.1992, vjetërsi kjo e konfirmuar nga DRSSH Kukës, e cila hedh poshtë kohën e fillimit të invaliditetit (viti 1984), e për rrjedhojë edhe pensionin e invaliditetit. Ky fakt është konstatuar edhe nga kontrolli i sektorit të ekspertizës mjekësore të ISSH-së datë 15.05.2000, por që nga DRSSH Kukës nuk është zbatuar...”

Pas takimit të bërë në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit me shtetasin Q.F, ai është shprehur se pensioni i invaliditetit i ka filluar në vitin 1997 dhe jo në vitin 1884, periudhë në të cilin ai ka qenë në marrëdhënie pune. Gjithashtu ai ka depozituar edhe një përgjigje të marrë nga ana e drejtorisë suaj, me nr.2791/2 datë 17.11.2014, me anë të së cilës është vënë në dijenë se nga rishqyrtimi i pensionit të tij, ka rezultuar debitor në masën 1.042.852 lekë. Koha e pagës është për periudhën 10.08.1997-30.07.2014.

Sa më lart, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, të paragrafit 2, të nenit 3, si dhe të paragrafit të parë, të nenit 18, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në të cilët thuhet se: *“Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”*, *“Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e këtij ligji...”*,

REKOMANDOJMË

Dërgimin e kopjeve të dokumentacionit të plotë të dosjes së pensionit të invaliditetit të shtetasit Q.F.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI